

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, bazuar në nenin 16 të Ligjit nr.03/L-079, për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut, nr.2006/50, për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private duke përfshirë pronën Bujqësore dhe ate Komerciale, kolegji në përbërje nga gjyqtarët, Beshir Islami kryetar i kolegjit, Ragip Namani dhe Jelena Krivokapić anëtar, me pjesëmarrjen e Bashkëpunëtorit Profesional Sherif Krasniqi, në çështjen juridike **të palës ankuese;**

R. Dj.,, R. Crna Gora

Kundër;

N.A.

Duke vendosur lidhur me ankesën e paraqitur, kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/260/2014, të datës 21 Tetor 2014, (lënda e regjistruar në AKP me numër KPA...), pas shqyrtimit të mbajtur me datë, 24 Prill 2019, merr;

AKTGJYKIM

- 1. Refuzohet si e pabazuar Ankesa e paraqitur nga R. Dj., kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/260/2014, të datës 21 Tetor 2014, për sa i përket kërkesës së regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronës me numër KPA...**
- 2. Vërtetohet Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/260/2014, i datës 21 Tetor 2014, për sa i përket kërkesës së regjistruar me numër, KPA...**

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike;

- Me datë 27 Nëntor 2006, R. Dj., (në tekstin e mëtuftjeshëm: pala ankuese), ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtuftjeshëm: AKP), me të cilën kërkon konfirmimin e të drejtës pronësore, dhe ri-posedimin në cilësinë e bartësit të drejtës pronësore, si bashkëpronare me 1/4 pjesë ideale, të ngastrave kadastrale, nr. ..., nr. ..., nr.... dhe nr..., në sipërfaqe të përgjithshme prej 1ha.04ar.53m2., (pa sipërfaqen e ngastrës së ndarë kad...), të cilat ndodhen në vendin e quajtur "Dobruna.", Komuna kadastrale ..., Komuna Gjakovë, (në tekstin e mëtejme; prona e kërkuar).
- Paraqitësja e kërkesës, (tani palë ankuese), pohon se e ka humbur mundësin e posedimit dhe shfrytëzimit të pronave të kërkuara si pasojë e konfliktit të viteve 1998/99, si datë të humbjes e shënon datën 11.06.1999. Po ashtu sqaron se pronat e kërkuara janë të uzurpuara dhe duke u shfrytëzuar nga Kooperativa Bujqësore në ..., dhe D. B..
- Me që ngastrat e kërkuara si më lartë sipas kërkesës KPA..., janë gjetur me rezultate të ndryshme të verifikimit në departamentin e kadastrit në Gjakovë, kërkesa fillestare

KPA17586, është ndarë dhe i përmban ngastrat kadastrale, nr. ..., nr. ..., dhe nr. ..., **ndërsa është krijuar kërkesë e re në AKP me numër KPA..., e cila tani e përmban ngastrën kadastrale numër ...,**(nuk është objekt shqyrtimi në këtë lëndë).

4. Së bashku me kërkesën në AKP ajo kishte dorëzuar *inter alia* ndër të tjera dokumentet vijuese;
- Kopjen e Fletës Poseduese nr..., Komuna Kadastrale ..., lëshuar nga Drejtoria Komunale e Gjeodezisë Gjakovë me datë 13.05.1982, sipas së cilës pala ankuese B. R. R. është bashkëpronare e pronave të kërkuara me 10/120 pjesë ideale, me familjarët e tjerë, dhe me P. Sh. Kooperativa Bujqësore ..., si dhe nëna e saj B. D.,(udov. R.),bashkëpronare me 20/120 pjesë ideale.
 - Certifikatën nga Libri Amë i të vdekurve, të dt. 21.01.1976, që e dëshmon vdekjen e babait të saj R. (M.) B.
 - Vendimin e Trashëgimisë nr. 20/76, dt.17.01.1995, lëshuar nga Gjykata Komunale në Gjakovë sipas të cilit pas vdekjes së babait të palës ankuese R. B., (i cili e kishte të drejtën e pronësisë me ¼ pjesë ideale të pronave në Fletën Poseduese nr.110, I RI, Zona kadastrale ..., dhe Fleta Poseduese nr..., I RI, Zona kadastrale ...), është trashëguar nga pala ankuese R. me 1/3, pjesë ideale, dhe nëna e saj D. B. me 2/3, pjesë ideale, ndërsa motra e saj J., kishte hequr dorë nga trashëgimia në favor të nënës së saj.
 - Aktgjykimin, Y. nr.2351/98,dt.25.11.1998, lëshuar nga Gjykata Supreme e Serbisë me të cilin anulohet Vendimi i Entit Republikan të Gjeodezisë në Beograd, nr. ..., i dt. 21.04.1998, dhe lënda i kthehet këtij organi në rivendosje.
 - Vendimin e komisionit për kërkesa pronësore banesore HPCC/D/1/92/2005/C, të dt.18.06.2005,me të cilin palës ankuese i ishte aprovuar e drejta në ri posedimin e pronës banore në ngastrën kadastrale nr..., sipas kërkesës së saj ds...
 - Certifikatën nr. ..., të dt. 18.03.2002, lëshuar sipas kërkesës së palës ankuese nga Enti Republikan i Gjeodezisë në Beograd, me qëllim të mbrojtjes së drejtave pronësore, me të cilin dëshmohet se në këtë organ, përkatësisht shërbimin për kadastër të paluajtshmërive në Gjakovë, është në rrjedhë procedura e vërtetimit të lëshimeve dhe mangësive në Operatin kadastral për Komunën Kadastrale ... dhe Komunën Kadstrale ..., gjithnjë sipas Aktvendimit të Entit Republikan për Gjeodezi, 03 nr. ..., të dt.09.02.2000, i nxjerrë sipas Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Serbisë Y.br.2351/98, dt.25.11.1998.
 - Deklaratën e dërguar në AKP nga ana e saj me datë 27.05.2009, pas shkëmbimit të informatave me këtë organ dhe ndarjes së kërkesës së saj në, KPA... dhe KPA..., e cila sqaron historikun e pronave të kërkuara lidhur me marrjen e një pjese të pronës për ndërtimin e rrugës dhe nga Kooperativa Bujqësore, etj.
5. Njoftimi i kërkesës për këtë pronë, nga AKP-ja ishte bërë me datë 10.07.2007. Sipas raportit të notifikimit prona e kërkuar, ngastrat kadastrale, nr. ..., nr. ..., nr..., dhe nr..., gjatë kohës së vizitës janë gjetur prona komerciale pa ndërtime, përkatësisht tokë jo e kultivuar dhe e pa uzurpuar. Notifikimit të pronës së kërkuar është bërë me datë 17.06.2010, për mes

publikimit Buletini zyrtar, nr.2 i UNHCR, në Komunë Gjakovë, Gjykatë Komunale Gjakovë, tek udhëheqësi i fshatit Muharrem Musa, njoftimi ishte vendosur në hyrje dhe dalje të fshatit, në pronën e kërkuar, dhe tek organet dhe institucionet tjera relevante si KPA regjioni Pejë ,DRC,OSCE UNHCR, Obudsperson.

6. Sipas Raportit të konsoliduar të verifikimit të sekretarisë së AKP-së, të datës 23.09.2014, të dokumenteve të paraqitura nga pala ankuese, Kopja e Fletës Poseduese nr.96, Komuna Kadastrale ..., lëshuar nga Drejtoria Komunale e Gjeodezisë Gjakovë me datë 13.05.1982, sipas së cilës pala ankuese B. R. R., është bashkëpronare e pronave të kërkuara me 10/120 pjesë ideale, me familjarët e tjerë, dhe me P. Sh. Kooperativa Bujqësore ..., si dhe nëna e saj B. D.(udov. R.),bashkëpronare me 20/120 pjesë ideale, është verifikuar negativisht si jo ekzistuese, ndërsa Aktgjykimi nr. ... i dt. 25.11.1998, i Gjykatës Supreme të Serbisë dhe Vendimi i Trashëgimisë, OV.nr.20/76 i dt. 17.01.1995, i Gjykatës Komunale të paraqitura po ashtu nga pala ankuese janë verifikuar pozitivisht.
7. Ngastra kadastrale nr..., sipas formularit të kërkesë është e paraqitur si kullosë, por sipas Fletës Poseduese kjo ngastër përbëhet nga një pjesë kullosë, shtëpi dhe oborr, ndërsa pas verifikimit në Fleta Poseduese figuron e përbërë nga një shtëpi, oborr dhe pemishte në emër pasuri shoqërore.
8. Gjatë përpunimit të kërkesës së palës ankuese, sekretaria e AKP-së, në kadastër Gjakovë me datë 02.03.2007, 17.09.2007, 10.09.2009, dhe 26.06.2014, kishte bërë verifikimin dhe kishte siguruar *ex officio* ,Fletat Poseduese përkatësisht Certifikatat e të Drejtave Pronësorë për pronat e kërkuara të kësaj lënde, nga kishte rezultuar se, ngastrat kadastrale, nr..., nr. ..., dhe nr. ..., janë gjetur të regjistruara jo në emër të palës ankuese por në emër të palëve të ndryshme të treta dhe në emër të kushërinjve të palës ankuese si vijon;
 - Ngastra kadastrale, numër ..., e regjistruar në Fletën Poseduese ..., është gjetur e regjistruar Pasuri Shoqërore, në emër të Kooperativës Bujqësore ... me 1/1, pjesë ideale, (azhurimi i bërë në vitin 1992 dhe 1995).
 - Ngastra kadastrale numër ..., Zona kadastrale ..., e evidentuar në Listën Poseduese numër ..., është gjetur se evidentohet në emër të bashkëpronarëve me nga ¼ pjesë ideale B. B., B. D., B. L., dhe B. R., nga L..
 - Dhe ngastra kadastrale, numër ..., sipas Listës poseduese numër ..., është gjetur e regjistruar në emër të S. J. (R.),rodj. B., nga Gjakova.
9. Gjatë komunikimit me sekretarin e AKP-së, pala ankuese ka sqaruar se prona e kërkuar ishte e babait të saj ndërsa pas vdekjes së tij ajo dhe nëna e saj nga gjykata janë shpallur trashëgimtare, se në atë kohë në vitin 1976, kishte filluar ndërtimi i rrugës për Prishtinë e cila kolon edhe nëpër tokën e tyre, dhe si pasojë prona u ishte shkatërruar duke u ndarë në dy pjesë dhe shpronësuar por nuk u ishte kompensuar. Po ashtu kishte deklaruar se në vitin 1993 pas shitjes së rreth 0.88,00ha.,tokë, familjes së D. B., familja e saj kishte kuptuar se së paku tre hektar tokë të tyre, nuk ishin regjistruar në kadastër në emër të tyre por në emër të palëve të treta, andaj për këtë i ishte drejtuar shërbimit Kadastral në Gjakovë, mandej

Prishtinë dhe me ankesa i është drejtuar edhe Gjykatës Supreme të Serbisë, dhe kjo çështje pronësore është ende kontestuese, e pa zgjidhur.

10. Me datë 21 Tetor 2014, KKPK-ja, me Vendimin numër, KPCC/D/A/260/2014, e hedhë poshtë kërkesën KPA... të palës ankuese, që i përfshinë ngastrat lëndore, nr..., ... dhe ..., Komuna Kadastrale ..., me sipërfaqe të përgjithshme prej 1ha.04ar,53m2, sipas arsyeve konkrete në paragrafin 18, për veç arsyeve në paragrafët e tjerë në vendimin grupor për shkak se, kërkesa e palës ankuese bie jashtë juridiksionit të Komisionit, pasi që posedimi i pronës së kërkuar nuk ishte humbur si rezultat i konfliktit të armatosur që kishte ndodhur në Kosovë gjatë viteve 1998-1999. Tutje ndër të tjera sqarohet se komisioni konstaton se në bazë të llojeve të ndryshme të dokumenteve dhe të siguruara *ex officio*, apo në bazë të vet deklaratave të palëve, dëshmohet se ka dështuar të tregoj se kërkesa e saj i përfshinë rrethanat që lidhen drejtpërdrejtë ose që rezultojnë nga konflikti i viteve 1998/99. Nga këto rrethana komisioni vlerëson se kërkesa e paraqitëses nuk i ka përmbushë kushtet për tu shqyrtuar sipas nenit 3.1 paragraf 3, të Rregullores së UNMIK-ut,2006/50, e ndryshuar me Ligjin nr.03/L-079, dhe rrjedhimisht kërkesa është jashtë juridiksionit të komisionit andaj si e tillë hedhet poshtë.
11. Vendimi i KKPK-së i ishte dorëzuar palës ankuese R. Dj. me datë 06.02.2015, e njëjta kundër tij me datë 20.02.2015, ka parashtruar ankesë.

Pretendimet e palës ankuese

12. Pala ankuese e kundërshton në tërësi Vendimin e KKPK-së, për shkak të cenimit thelbësor të dispozitave procedurale, dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.
13. Sipas palës ankuese nuk kuptohet se sipas cilave konkludime i janë hedhur shtatë kërkesat e saj nga AKP-ja pas kalimit të 15 viteve sepse nuk janë dhen arsye të qarta dhe konkrete, tutje në ankesë e përshkruan historikun e gjendjes së pronave të saj dhe humbjen e tyre, njëjtë si edhe në kërkesë dhe deklarimeve plotësuese me shkrim dhe komunikimeve që i ka dhënë në AKP, në ankesë nuk jep sqarime konkrete lidhur me pronat lëndore sipas kërkesës KPA..., të vendosura me vendimin e ankimuar por thekson në mënyrë të përgjithësuar ndër të tjera se; pronat e kërkuara janë të saj dhe nënës së saj, të trashëguara nga babai i saj, se e tyre është prona në sipërfaqe të përgjithshme prej 9.77.60 ha, në Zonën Kadstrale ... dhe 2.64.40 ha, dhe në Zonën Kadstrale Gjakovë, ndërsa kadastrin në mënyrë të kundërligjshme ua ka zvogëluar pronën për 7.13.29ha, që është rast për policin, se ekziston konflikt-konfuzion në mes të drejtës formale të gjendjes në libra publik dhe të drejtës materiale juridike të çështjes dhe në disa raste janë vërejtur lëshimet në kadastrin, se nuk i është dhënë asnjëherë gjendja lidhur me pronat e saj nga kadastrin në Gjakovë dhe as nga AKP, andaj konsideron se ende ka lëshime edhe pse për këtë ekzistojnë aktgjykime të plotfuqishme, (i citon dokumentet të cilat edhe më parë i ka paraqitur në AKP të viteve 90 -ta dhe pas vitit 2000 të lëshuara nga Gjykata Supreme e Serbisë dhe Enti Republikan i Gjeodezisë, në Beograd). Tutje i përshkruan vendimet KKPC (HPD-së), që sipas saj asnjëherë nuk janë ekzekutuar për t'iu kthyer posedimi i pronës dhe shtëpisë së tyre e cila është bllobuar por

asnjëherë nuk kanë mundur të kenë qasje në te dhe tani kërkesa e saj hedhet poshtë. Po ashtu thekson se kërkesat e saj janë vendosur në mënyrë diskriminuese sepse kjo është përzënë nga pasuria e saj për shkak të rrethanave të luftës ndërsa nëna e saj është vrarë, andaj vlerëson se Vendimi i KKPK-së, është jo i drejtë, pa bazë ligjore, i pa kuptueshëm, dhe jo i arsyetuar, Etj.

Arsyetimi ligjor

14. Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës pretendimeve ankimore dhe sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194, të Ligjit Nr.03/L-006, mbi Procedurën Kontestimore, gjykata gjen se ankesa është e pranueshme dhe e afatshme sipas nenit 186 par.1, lidhur me nenin 196 të LPK.
15. Gjykata Supreme, pasi shqyrtoi pretendimet në ankesë dhe përmbajtjen e dosjes së lëndës, konstaton se Vendimi KKPK-së nuk është i përfshirë me asnjë gabim thelbësor apo zbatim të gabuar të së drejtës së aplikueshme materiale dhe as nuk mbështetet në vërtetimin jo të plotë dhe të gabuar të fakteve. Prandaj ankesa nuk mund të miratohet.
16. Sipas nenit 3.1 të Ligjit nr. 03/L-079, KKPK-ja, ka kompetencë të zgjidh kërkesat pronësore që kanë të bëjnë me konfliktin dhe kërkesat për të drejtën pronësore, “që drejtpërdrejtë kanë të bëjnë me konfliktin e armatosur që ka ndodhur në mes të datave 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999, apo që rezultojnë nga ai. Prandaj paraqitësi i kërkesës duhet të paraqes jo vetëm titullin e pronësisë mbi pronën e paluajtshme private, por edhe të dëshmoj se ai apo ajo nuk është në gjendje ti ushtroj këto të drejta pronësore për shkak të rrethanave që ndërliken drejtpërdrejtë me, apo rezultojnë nga konflikti i armatosur.
17. Nga provat në shkresa të lëndës të dhe administruara nga KKPK-aj, pa dyshim vërtetohet se prona e kërkuara nuk ishte humbur si pasojë e konfliktit të viteve 1998-99, ashtu si pretendon pala ankuese sepse i mungon titulli i pronësisë. E njëjta paraqet dokumentacion të trashëgimisë sipas të cilit ajo dhe nëna e saj paraqiten si bashkëpronare të pronave të kërkuara dhe të tjerave si në kërkesat e tjera të paraqitura në AKP, megjithatë dëshmitë e tjera të cituara si në paragrafin katër të këtij aktgjykimi të ofruara nga pala ankuese, nuk e pasqyrojnë gjendjen reale të drejtës pronësore dhe janë në kundërshtim me faktet dhe provat e siguruar *ex officio*, nga Sekretaria e AKP-së, sepse pronat e kërkuara- ngastrat kadastrale numër ..., ... dhe ..., nga ky organ në kadastër janë gjetur të regjistruara në emër të palëve të treta, si u përshkrua në paragrafin e tetë (8), të këtij aktgjykimi, dhe të paraqitura si (në faqe 072-105, të kësaj lënde, në raportin e konsoliduar i verifikimit të AKP-së).
18. Sipas Raportit të konsoliduar të verifikimit nga AKP, të datës 23.09.2014, Kopja e Fletës Poseduese e paraqitura nga pala ankuese, nr. ..., Komuna Kadastrale ..., lëshuar nga Drejtoria Komonale e Gjeodezisë në Gjakovë me datë 13.05.1982, sipas së cilës pala ankuese B. R. R., paraqitet se është bashkëpronare e pronave të kërkuara me 10/120, pjesë ideale, me familjarët e tjerë si në këtë Fl. poseduese, dhe me P. Sh. Kooperativën Bujqësore ..., si dhe

nëna e saj B. D.(udov. R.),bashkëpronare me 20/120, pjesë ideale është verifikuar negativisht si jo ekzistuese në Kadastër Gjakovë.

19. Po ashtu nga sqarimet e vet palës ankuese në AKP dhe tani në ankesë, si dhe Përgjigjeve, Njoftimeve dhe Vendimeve të lëshuara nga Enti Republikan i Gjeodezisë të Serbisë, të viteve 1993- 2002, dhe Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Serbisë, Y.nr.2351/98,dt.25.11.1998, (këto prova i bashkëngjit kërkesës dhe tani në ankesë), pa dyshim vërtetohet se paqartësitë dhe kontesti lidhur me pronat e kërkuara, dhe disa prona të tjera sipas kërkesave të tjera në AKP, lidhur me të drejtën pronësore të palës ankuese, janë të karakterit familjar dhe të tjera, që kanë ekzistuar shumë vite para periudhës së konfliktit të viteve 1998/99, andaj për këto arsye pala ankuese i ishte drejtuar organeve të cekura si më lartë administrative të kadastrit, dhe me padi organeve gjyqësore prej vitit 1993 e tutje, për të dëshmuar të drejtën e saj pronësore, por nuk dëshmohet se këto procese ishin përfunduar me një vendim apo zgjidhje përfundimtare të kontestit pronësor, lidhur me lëshimet dhe mangësitë në Operatin kadastral në Komunën Kadastrale Bec dhe Qerim, që i përfshinë edhe ngastrat objekt i kësaj lënde. Pra nga këto fakte dëshmohet se humbja e posedimit të pronave të cilat ishin kontestuese qysh më herët në drejtim të titullarit të drejtës pronësore nuk mund të ndërliidhen si të humbura si pasojë konfliktit të viteve 1998/99, sepse ishin kontestuese që më parë.
20. Pala ankuese dhe bashkëshorti i saj për mes deklaratave të shkruara dhe bisedave me Sekretarinë e AKP-së, kishin konfirmuar këto fakte se familja e saj kishte pasur kontest pronësor para konfliktit me personat e tretë të afërm së saj, të cilët kishin arritur ti regjistronin këto prona në emër të tyre në organin Kadstral.
21. Lidhur me pronën e kërkuar dhe të tjerat me kërkesa tjera, pala ankuese në letrën e saj informuese për AKP-në,(faqe 49-51, në shkresa të lëndës), ndër të tjera kishte deklaruar se; “në vitet 70-ta, për ndërtimin e rregës Gjakovë Prishtinë, i ishte shpronësuar toka por asnjëherë nuk i ishte kompensuar, me këtë i ishin dëmtuar pyjet, livadhet, arat të cilat i ishin ndarë në dy pjesë, ndërsa Kooperativa pa bazë ligjore dhe pa ndarje fizike kishte hyrë në posedim të disa pronave të saj dhe për këtë gjithherë kishin mosmarrëveshje ku ndërhynte edhe Policia, po ashtu deklaroi se në vitin 1993 pasi i kanë shit 88 ari tok familjes B., kanë vërejtur se në kadastër pronat e tyre janë të regjistruar në mënyrë të dy Fishta, ndërsa këtyre u janë mëshëh shënimet kadastrale për së paku 3 hektar, andaj prej atëherë kanë filluar tu drejtohen organeve të kadastrit dhe me padi gjykatës, për të fituar të drejtën e tyre në pronat kontestuese.”
22. Nga faktet e theksuara si më lartë dhe dokumentet e paraqitura nga pala ankuese nuk paraqitet gjendja aktuale e pronave, nuk pasqyrohen ndryshimet të cilat ishin bërë në kadastër pas viteve 1956 dhe 1976 dhe në vitet e nëntëdhjeta, nuk i përmbajnë të dhënat aktuale kadastrale të pronave të kërkuara dhe si të tilla janë kontradiktore me shënimet në regjistrat kadastral ashtu si u argumentua në vendimin e KKKPK-së, dhe si më lartë në këtë aktgjykim.

23. Nga shënimet aktuale në kadastër të ekzaminuara *ex officio*, nga AKP-ja ka rezultuar se këto prona janë të regjistruara në emër të palëve të treta, dhe ato ngastra kad. 1294, Komuna kad. Bec, e regjistruar si Pasuri Shoqërore, Kooperativa Bujqësore ... Mandej ngastra kad...., Komuna kad. ..., e regjistruar në emër të palëve të treta ,bashkëpronarëve me nga ¼ pjesë ideale, B. B., B. D., B. L.a, dhe B. R., nga ... Dhe ngastra kad...., Komuna Kad. ..., e regjistruar në emër të pronares S. J. (R.), rodj. B, nga Gjakova. Andaj nga kjo gjendje aktuale në tërësi provohet se pala ankuese nuk e dëshmon të drejtën pronësore me titull juridik mbi pronën e paluajtshme private, ashtu si parashihet në 3.1 të Ligjit nr. 03/L-079, për të pasur kompetencë AKP-ja, për të zgjidhë kërkesën e saj.
24. Gjykata Supreme, sipas konkludimeve të cekura si më lartë, dhe provave në shkresa të lëndës padyshim vlerëson se, KKKPK si në vendimin e saj, ka vendosur drejtë dhe në baza ligjore kur ka gjetur se kërkesa e palës ankuese nuk është përmbajtjesore dhe nuk i plotëson kushtet ligjore për tu shqyrtuar dhe vendosur ashtu si parashihet në nenin 3.1, paragraf 3., të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, andaj në mungesë të juridiksionit të AKP-së, për të vendosur mbi meritat e kërkesës e njëjta është hedhë poshtë si jo lëndore.
25. Nga të lartë cekurat e në përputhje me nenin 13.3 (c) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.
26. Ky aktgjykim nuk e paragjykon të drejtën pronësore lidhur me pronën e kërkuar të palës ankuese apo palës-ve të interesuara dhe nuk paraqet pengesë për iniciimin e procedurës para organit, apo gjykatës kompetente, nëse e vlerësojnë me interes legjitim.

Këshillë ligjore;

Sipas nenit 13.6, të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo atyre të jashtëzakonshme juridike.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

GSK-KPA-A-12 -2016, me datë 24 Prill 2019

Bashkp. Profesional

Sherif Krasniqi

Kryetari i Kolegjit,

Beshir Islami